



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 146, Datë 28.05.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 100 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1291/4 prot., datë 26.05.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 132, datë 02.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, i ndryshuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1291 prot., datë 28.04.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim për modifikimin e licencës, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, në Aneksin A të saj, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të licencës.
- Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 11.01.2023 dhe Kontratës me nr. 31 rep, nr. 13 kol., datë 27.01.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria është pajisur me të drejtën për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100MW, dhe

veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt konçesioni, në zonën kadastrale nr. 1090, Njësia Administrative Ballsh, , Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.

- Nga shqyrtimi paraprak i dosjes ka rezultuar se shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit, si e tillë me e-mailin nr. 1291/1 prot., datë 05.05.2026, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i sjellë në vëmendje kryerjen e pagesës përkatëse.
- Rezulton se në datën 15.05.2026, shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores si dhe ka shlyer pagesat e rregullimit.
- Po ashtu, me e-mailin e saj të datës 15.05.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/2 prot., datë 18.05.2026, shoqëria ka paraqitur disa saktësime/sqarime në lidhje me aplikimin e saj, duke shtuar se kërkon të ndryshojë dhe numrin e paneleve, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.
- Si e tillë, vlerësohet se afati për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë të fillojë nga kryerja e pagesës dhe paraqitjes së saktësimeve të objektit të kërkesës së saj.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave (a, b, d, e, f dhe g).
- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, gërma “c” të Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve të saj për ndryshimin e kërkuar në Aneksin A të licencës.
- Po ashtu, në kuadër të një informacioni shtesë, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë që të depozitojë në ERE informacion mbi mënyrën se si parashikon të financojë investimin përkatës për vendosjen e këtyre veprave ndihmëse/njësive depozituese të energjisë elektrike.
- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 132, datë 02.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 MW, duke ndryshuar numrin e paneleve dhe duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI